



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



RAPORT I VEÇANTË

Për situatën e krijuar pas përmbytjeve në qarkun e
Shkodrës.

Hyrje

Gjatë muajit dhjetor 2010 qarku i Shkodrës u përball për herë të dytë me përmbytje të mëdha të cilat arritën të preknin jo vetëm zonat e banuara të këtij qyteti, kryesisht lagjet që ishin afër me Liqenin e Shkodrës, por edhe komunat dhe fshatrat që shtriheshin përgjatë shtratit të Lumit Drin dhe Buna.

Gjendja e krijuar ishte alarmante për banorët e Shkodrës në përgjithësi, të cilët ishin të prekur direkt apo indirekt nga përmbytja e krijuar, duke ngjallur pasiguri dhe shqetësim për jetën dhe shëndetin e banorëve, por edhe keqardhje për situatën me të cilën po përballlej qyteti i tyre i lindjes apo origjinës, duke qenë se pamjet dhe realiteti që të ofrohej ishin të paimagjinueshme dhe të papërsëritura më përpara.

Veprimtaria e Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit fillimisht ka marrë në shqyrtim me iniciativën e tij ankesën e banorëve të qarkut Shkodër, kryesisht të Komunave Bërdicë dhe Anamali, të cilat shtrihen shumë afër qytetit të Shkodrës, nisur edhe nga protestat e organizuara nga këto të fundit pas zvarritjeve disa mujore për pagimin e dëmeve të vlerësuara nga grupet e posaçme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Kryetari i Komunës Bërdicë, figuronin vetëm në Fshatin Trush rreth 400 familje të prekura dhe dëmtuara nga përmbytjet.

Duhet theksuar fakti se, gjatë verifikimit dhe bisedave me banorët e përfshirë në protesta, por edhe të tjerë të prekur nga përmbytjet dhe që presin të dëmshpërbehen, pretendimi i tyre nuk kishte të bënte me masën e dëmshpërblimit të caktuar, por me pagimin e asaj shume të vlerësuar.

Nga ana tjetër, duhet theksuar edhe fakti se asnjë nga banorët nuk kishte fare dijeni apo të ishte njohur më aktin e vlerësimit, për të qenë korrekt apo për të patur një farë njohurie mbi vlerësimet e kryera.

Pretendimi i tyre kryesor është që të dëmshpërblehen sa më shpejt nisur nga dy arsye kryesore;

-në kohën e kryerjes së inspektimit nga ana jonë kishin kaluar mbi 7 muaj dhe ato jetonin ende me barrën e borxheve për riparimin e dëmeve,

-qënia në prag të sezonit të vjeshtës dhe dimrit gjatë të cilave priten reshje e për këtë shkak banorët shpreheshin se ekzistonte një rrezik shumë i lartë potencial për përmbytje të tjera të rradhës.

Gjatë kësaj periudhe, nuk ishte miratuar asnjë akt që të parashikonte dhe rregullonte mënyrën e dëmshpërblimit të banorëve të qarkut Shkodër, duke shtuar edhe pakënaqësitë dhe reagimet e tyre ndaj këtyre zvarritjeve, ndërkohë që u ishte premtuar ndihmë konkrete nga shteti pas kalimit të fazës së emergjencës, me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomive të tyre familjare dhe mbulim i dëmeve të shkaktuara.

Lidhur më këtë fakt, Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua me anë të dy shkresave zyrtare Drejtorit të DPEC, por nuk patëm asnjë reagim zyrtar nga ana e tij lidhur me procedurat e ndjekura dhe dokumentacionin e përpiluar,

procedurat që po ndiqeshin nga kjo Drejtori për hartimin dhe delegimin e dosjes së kompensimit në Ministrinë e Financave dhe Këshillin e Ministrave për miratimin e aktit përfundimtar, në të cilin do të parashikoheshin personat që do kompesoheshin, vlerat monetare për secilin si dhe procedurat përmes të cilave do të kryhej ky kompesim.

Gjatë verifikimeve tona, u konstatua se Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 842 datë 06.12.2011 "Për miratimin e vlerës së kompesimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës", pra rreth një vit nga koha e përmbytjeve të ndodhura.

Në këtë vendim u miratua vlera e kompesimit të dëmeve të shkaktuara në shumën 1 112 303 342 lekë si dhe listat e 7563 familjeve dhe subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, së bashku me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kulturat bujqësore dhe në biznese, sipas listave të njësisive të qeverisjes vendore. Vendimi i qeverisë parashikon listën e familjeve të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kultura bujqësore, për Bashkinë Shkodër dhe komunat përreth saj. Kështu, sipas këtij vendimi, në Bashkinë Shkodër përfitojnë 475 familje gjithsej në shumën totale 34.655.150 lekë. Ndërsa në komunën Gruemirë, 46 familje përfitojnë 5.471.900 lekë; në komunën Kastrat, 8 familje përfitojnë 1.093.800 lekë; në komunën Gur i Zi, 964 familje përfitojnë 35.008.150 lekë; në Koplík Qendër, 39 familje përfitojnë 1.272.900 lekë; në komunën Rrethinat, 8.535.927 lekë; në komunën Ana e Malit, 1015 familje përfitojnë 184.240.510 lekë; në komunën Bërdicë, 1447 familje përfitojnë 184.633.710 lekë; në komunën Velipojë, 367 familje përfitojnë 64.846.577 lekë; në komunën Bushat, 1683 familje përfitojnë 176.577.404 lekë; në komunën Dajç, 1360 familje përfitojnë 395.490.999 lekë.

Zvarritjet e dëmshpërblimit dhe dyshimet mbi përfituesit

Lidhur me aktin e sipërcituar, pranë Avokatit të Popullit parashitroi një ankesë Kryetari i Komunës Anamali, z. Xhevat Mollca, i cili shprehu shqetësimin e banorëve të Komunës që ai drejton lidhur me shkelje të procedurave dhe favorizime gjatë konstatimit të dëmeve të shkaktuara gjatë përmbytjeve në pronat e fermerëve të kësaj Komune.

Duhet theksuar fakti se pas miratimit të këtij akti, janë shfaqur edhe pakënaqësitë e para të fermerëve lidhur me masat e dëmshpërblimit dhe përfshirjen e padrejtë të personave në listat e përfituesve.

Konkretisht në ankesën e Kryetarit të Komunës Anamali bëhet e ditur se nuk janë përfshirë në lista persona që realisht janë të dëmtuar nga përmbytjet, emra që nuk janë banorë të Komunës Anamali, ndarje fiktive të anëtarëve të së njëjtës familje me qëllim të rritjes artificiale të shumave të përfitimit për një dëm apo pronë të përmbytur, përfshirje e familjeve që nuk janë përmbytur realisht, si dhe favorizim në shumat e përfitimit për familjarë dhe miq të ngushtë të anëtarëve të Komisionit vlerësues.

Në ankesën e tij, z. Mollca ka bashkëngjitur edhe listën e personave të dëmtuar dhe që janë të përjashtuar nga lista e dëmshpërblimeve, e më konkretisht bëhet fjalë për shtetasit:

Fahri Veli Hoti, Nail Veli Hoti, Amir Haxhi Mani, Shtjefën Pal Doda, Shan Shtjefën Doda, Hysen Asllan Hasi, Afrim Besim Lini, Fadil Alush Kraja, Fadil Halit Zeneli, Isa Tahir Kopshtari, Isa Met Bajrami, Muhamet Shemsi Lani, Xhelal Murat Kopshti dhe Agim Murat Kopshti.

Gatë verifikimit të dokumentacionit dhe ankesave të parashtruara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit edhe nga banorët e komunave të tjera të prekura nga përmbytjet, na rezultoi se edhe shtetasi Halil Mlloja, banor i fshatit Trush në komunën e Bërdicës, nuk figuronte në listën e përfituesve nga VKM e sipërcituar, prandaj u përfshi në rekomandimin tonë për tu verifikuar më pas përmes dokumentacionit nga ana e Drejtorisë Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Sa më sipër Kryetari i Komunës Anamali, duke parashtruar pretendimet dhe shqetësimet e banorëve të Komunës, kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit me qëllim shqyrtimin dhe verifikimin e këtyre pretendimeve, si dhe përfshirjen e banorëve të veçuar, por të prekur nga përmbytjet, në listat e përfituesve të dëmshpërblimit.

Në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” ne kemi ndërmarrë një proces hetimi lidhur duke kërkuar shpjegime zyrtare nga ana e DRBUMK lidhur me procedurat, dokumentacionin dhe kriteret e vlerësimit të dëmëve nga ana e Komisioneve vlerësuese të pasurive të fermerëve të kësaj zone.

Në përgjigje të kërkesës tonë për informacion, Drejtori i DRBUMK Shkodër na informon se disa nga emrat e listuar në shkresën tonë janë lënë në harresë nga ana e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Komunës Anamali.

Nga ana jonë u gjykua se ky është një fakt i cili tregon për parregullsi në ushtrimin e funksionit të Komisionit të Vlerësimit të Komunës Anamali si dhe subjektivizëm të anëtarëve të tij në përpilimin e listave të personave të dëmtuar, që duhet të përfitonin dëmshpërblim. Anëtarët e përshirë në këtë Komision, si dhe personat e tjerë që kanë kryer procedurat respektive, janë nëpunës shtetëror e në këtë kuadër janë të detyruar të zbatojnë detyrimet që u janë ngarkuar me ligj dhe ti përmbushin ato në mënyrë rigorozë, përderisa kanë pranuar që të jenë pjesë e këtij procesi.

Nga ana tjerër, Avokati i Popullit vlerësoi se është i mundur rivlerësimi i pretendimeve të parashtruara, duke patur parasysh edhe dokumentacionin e disponueshëm si dhe akt-vlerësimet e anëtarëve të Komisionit të cilat i kanë konstatuar tashmë dëmet e shkaktuara.

Veçimi dhe dallimi i personave mbi baza subjektive, jo vetëm sjell cënim të drejtave dhe interesave të ligjshme të banorëve të prekur nga përmbytjet, por që nuk figurojnë si përfitues të dëmshpërblimit, por edhe mosmarrëveshje dhe përplasje mes banorëve të dy grupeve, çka nuk i shërben zgjidhjes së problemit dhe zbutjes së pasojave sociale që po përjetonin ato pas periudhës së përmbytjeve.

Në këtë kuadër, në interes edhe të shqyrtimit dhe vlerësimit përfundimtar të këtyre problemeve të konstatuara me pasuritë e banorëve të komunës Anamali, si dhe shmangien e mosmarrëveshjeve të mundshme, nga ana jonë u kërkua angazhimi i strukturave të përfshira në këtë proces, kryesisht i DRBUMK

Shkodër, në verifikimin e pretendimeve të parashtruara për personat e përfshirë në rekomandimin zyrtar, me qëllim që ato të përfshiheshin në listën e përfituesve të dëmshpërblimit, ashtu si edhe banorët e tjerë të prekur nga përmbytjet.

Nga ana jonë u gjykua se në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektonin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuonin në realizimin dhe respektimin të këtyre të drejtave. Në këtë kuadër u citua edhe Ligji nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 10 parashikon shprehimisht se:

“Administrata publike, në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të personave private”.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura me lart, ku doli mëse e nevojshme përmbushja dhe zbatimi korrekt i dispozitave ligjore, Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, duke vënë në dijeni edhe Ministrinë e linjës, kryerjen e procedurave administrative dhe rivlerësimin e akteve me qëllim përfshirjen e banorëve të Komunës Anamali në listat e dëmshpërblimit.

Në përgjigje të rekomandimit tonë të sipërcituar, Drejtori i DRBUMK Shkodër na informoi se grupet e vlerësimit, specialistët agronom, veterinerë si dhe inxhinier mekanik kishin bërë rishikimin e të gjitha shënimeve për verifikimin e pasaktësive të mundshme të bëra gjatë procesit të vlerësimit rast pas rasti dhe rakordimin e të gjithë fermerëve që kishin ankimuar dhe ishin përfshirë në shkresën tonë zyrtare në mënyrë nominale.

Më tej ai hodhi poshtë pretendimet për rritje artificiale të shumave të përfitimit pasi listat ishin hartuar mbi bazën e çertifikatës personale ose familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile të Komunës si dhe aprovimi i kryeplakut.

Ndërkohë që na sqaroi se lidhur me ankuesin Halil Mlloja, vlerësimi i dëmit ishte bërë në emër të babait të tij.

Së fundmi, ai theksoi se i gjithë dokumentacioni i vlerësimit nëpërmjet Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë i është përcjellë Këshillit të Qarkut Shkodër, për ta deleguar më tej në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile pranë Ministrisë së Brendshme për përgatitjen e një projekt-vendimi të ri për fermerët që kishin ankimuar.

Gjithsesi nga ana jonë, duke qenë se ky problem është ndjekur në vazhdimësi, nga komunikimet e vazhdueshme me drejtuesit e pushtetit lokal si dhe verifikimit të botimeve zyrtare, ky projekt-vendim nuk është miratuar dhe publikuar ende.

Pra kemi ende fermerë, të cilët pas procesit të ankimit nuk janë përfshirë formalisht në një Vendim të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga fakti se nga ana e organit të administratës publike të përfshirë në procedurat e vlerësimit, pranohet shprehimisht gabimi dhe lënia në harresë e tyre.

Dëmshpërblimi real

Gjithsesi nga ana e Avokatit të Popullit u verifikua fakti se fermerët dhe subjektet tregtare, të parashikuar shprehimisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave, të prekur nga përmbytjet ende nuk po përfitonin dëmshpërblimet e parashikuara në këtë Vendim, duke e bërë atë thjesht një akt i cili nuk kishte sjellë pasojat e dëshiruara dhe të shumëpritura nga të prekurit, por nga ana tjetër duke e kthyer atë në një akt i cili nuk kishte sjellë edhe ato pasoja për të cilat ishte miratuar nga ana e Këshillit të Ministrave, duke ngjallur në këtë mënyrë reagime të forta në komunitetin e personave të prekur.

Lidhur me këtë fakt, Avokati i Popullit analizoi dhe shqyrtoi përgjegjësinë e organeve të përfshirë në procesin e pagimit të dëmeve dhe procedurat që do të ndiqeshin nga ana e tyre.

Në rastin konkret, VKM nr. 842 datë 06.12.2011 parashikon kompensimin e dëmeve për kulturat bujqësore dhe subjektet tregtare, procedurë e cila nuk kishte filluar, në gjykimin tonë, edhe për faktin se nuk ishte miratuar ende Udhëzimi i përbashkët i parashikuar në pikën 4 të këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave.

Avokati i Popullit u përqendrua pikërisht në procesin e dëmshpërblimit dhe përshpejtimin e këtyre procedurave, me qëllim që përfituesit të mos mbeteshin në pritje të përmbytjes së premtimeve dhe zbatimit të detyrimeve ligjore, të parashikuara tashmë në një akt konkret të Këshillit të Ministrave.

Nga ana jonë u gjykua se zvarritjet administrative në dhënien e dëmshpërblimeve të parashikuara, e shndërrojnë VKM nr. 842 datë 06.12.2011 në një akt formal, i cili nuk sjell pasojat e dëshiruara dhe të synuara nga Këshilli i Ministrave, për dëmshpërblimin e banorëve, lehtësimin e pasojave dhe rikthimin në normalitet pas situatës katastrofike që u krijua gjatë ditëve të përmbytjeve.

Për të gjitha arsyet dhe konstatimet e përmendura me lart, ku doli mëse e nevojshme përmbytja dhe zbatimi korrekt i parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompesimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave miratimin e Udhëzimit të përbashkët në zbatim të kërkesave të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompesimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave theksohet fakti dhe problemi kryesor i kësaj çështje, e pikërisht, mungesa e kryerjes së transfertës së shumës së parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nga KESH në llogarinë e unifikuar të Thesarit “Depozitë e Qeverisë” në Bankën Shqipërisë. Ndërkohë që thekson se nga Dega e Thesarit Shkodër nuk ka ankesa se shkaku i mospagimit të kompesimit të dëmeve për banorët e zonave të përmbytura në qarkun e Shkodrës ishte pikërisht mungesa e Udhëzimit të përbashkët, miratimi i të cilit ishte rekomanduar nga ana jonë, por pikërisht mungesa e fondeve për të realizuar procedurën e

kompesimit. Lidhur me këtë procedurë, ai thekson se procedura e sistemit të thesarit për personat përfitues është parashikuar në Udhëzimin nr. 41 datë 06.12.2010, si një procedurë standart dhe unike e sistemit të informatizuar financiar të Qeverisë, e cila nuk mund të ndryshonte për çdo vendim i cili aprovohet në lidhje me pagesat e përfituesve.

Nga ana jonë ishte verifikuar edhe konstatuar fakti se Këshilli i Ministrave parashikonte shprehimisht miratimin e një Udhëzimi të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi, duke patur parasysh edhe specifikën e veçantë të çështjes së përmbytjeve në Shkodër, ndërkohë që nga Ministria e Financave u mbajt qëndrimi zyrtar se nuk ishte e nevojshme miratimi i një akti të tillë nënligjor.

Në analizë të qëndrimit të mësipërm zyrtar, Avokati i Popullit thekson se në rekomandimin tonë, i jemi referuar shprehimisht ankesave të qytetarëve për mosdhënie të dëmshpërblimit, në mbrojtje të të cilëve ishte angazhimi jonë institucional.

Ndërkohë që nga Ministria e Brendshme nuk pati asnjë qëndrim zyrtar ndaj rekomandimit tonë, pavarësisht nga fakti se kjo Ministri ishte e përfshirë konkretisht që në fillim në procesin e konstatimit të dëmeve, përpilimit të dokumentacionit si dhe kryerjes së procedurave të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave.

Fondi i dëmshpërblimit

Gjithsesi duke patur në fokus kryesor pagimin e dëmeve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”, Avokati i Popullit konstatoi se në pikën 3 të këtij Vendimi parashikohet shprehimisht se fondi prej 1 112 303 342 (një miliard e njëqind e dymbëdhjetë milionë e treqind e tre mijë e treqind dyzet e dy) lekësh të përballohet nga shuma, në të njëjtën vlerë, që do të paguajë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), në buxhetin e shtetit, në një llogari të veçantë.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit i rekomandoi Administratorit të KESH, duke vënë në dijeni edhe Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, alokimin e fondeve për dëmshpërblimin e banorëve të Qarkut Shkodër në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, Administratori i KESH thekson se nga ana e tyre është vlerësuar dëmshpërblimi i banorëve të përmbytur jo vetëm si detyrim ligjor, i cili buron nga akti i cituar në rekomandimin tonë zyrtar, por edhe si detyrim human, por vë në dukje edhe vështirësitë financiare të korporatës për shkak të moslikuidimit të faturave të energjisë së blerë nga ana e CEZ Shperndarje.

Së fundmi, ai thekson se KESH do të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në

kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”.

Nga ana tjetër ka patur një reagim zyrtar edhe nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, i cili përmes një shkrese drejtuar Administratorit të KESH kërkon që të informohet mbi konstatimet e arritura nga Avokati i Popullit lidhur me moszbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011.

Gjithsesi, nga KESH është shprehur qëndrimi për mungesën e fondeve, duke lënë pezull të gjithë procedurën e dëmshpërblimit të të prekurve nga përmbytjet.

Pra, i gjithë problemi dhe zvarritjet që po konstatohen tashmë në vazhdimësi nga ana e Avokatit të Popullit, të cilat kanë shtuar edhe reagimet dhe ankesat e banorëve të prekur nga përmbytjet, është mungesa e fondeve, të cilat KESH ia faturon CEZ, duke mbyllur qarkun dhe hedhur përgjegjësitë nga njëri organ i administratës publike tek subjektet e tjera, por që në këndvështrimin tonë, nuk përbëjnë shkaqe të ligjshme apo të parashikuara në akte të tjera me fuqi juridike, për të mos ekzekutuar një detyrim të parashikuar ndaj këtyre banorëve, të cilët përballuan me shumë vështirësi dhe sakrificë atë situatë të papërfunduar më përpara nga breza të tërë.

Erozioni i tokave bujqësore

Në takimet që kemi patur vazhdimisht me komunitetin e prekur nga përmbytjet, por edhe gjatë inspektimit në mesin e muajit janar, në shtratin e lumit Drin dhe Buna, të cilët respektivisht lagin komunat e Bërdicës dhe Anamalit, Avokati i Popullit dhe përfaqësues të pushtetit vendor konstatuan devijim të shtrimit të rrjedhjes së këtyre lumenjve, si pasojë e punimeve që po bëheshin në hidrocentralin e Ashtës si dhe mungesës së investimeve për ngritjen e argjinaturave edhe në këto Komuna të prekura nga përmbytjet e viti 2010. Shembullin më tipik dhe të dhimbshëm na e parashit shtetasi Vlash Kaçupaj, toka e të cilit po rrëmbehej nga ujrat e lumit Drin, i cili nuk ishte as në nivelin e tij mesatar të prurjeve, por që kishte gërryer një sipërfaqe lehtësisht të verifikueshme, dhe që pas disa vitesh ankuesi nuk do të mund ta gëzonte dhe dispononte më atë pasuri.

Krahas kësaj, i njëjti rrezik i kanosej edhe shtëpive e bizneseve të ngritura afër brigjeve të këtyre dy lumenjve, por që në një të ardhme të afërt nuk do të ekzistojnë më për shkak të erozionit dhe vërshimit të lumenjve drejt këtyre brigjeve, si pasojë edhe e ndryshimit të rrjedhës së tyre, sidomos në lumin Drin, për shkak të punimeve që po realizoheshin në hidrocentralin e Ashtës.

Me shqetësim u vërejt edhe shfrytëzimi i paligjshëm i inerteve në shtratin e lumit Drin nga subjekte të paligjshëm, të cilat sapo konstatuan praninë e personave që po i vëzhgonin, u tërhoqën, për të vazhduar më pas me veprimtarinë e tyre, për të cilën edhe drejtuesit e pushtetit vendor u shprehën të pafuqishëm për ta frenuar, si shkak edhe i mungesës së juridiksionit territorial dhe interesave të fuqishme ekonomike që fshihen pas aktiviteteve të tilla.

E njëjta situatë është verifikuar edhe gjatë ditëve të para të muajit maj, gjatë të cilave niveli i reshjeve dhe i prurjeve të këtyre lumenjve nuk ishte as në

nivelin mesatar, por rreziku i gërryerjes së tokës në zonën e Anës së Malit në breg të lumit Buna dhe Bërdicës në breg të lumit Drin, paraqitet tejet shqetësuese dhe alarmante për banorët e këtyre zonave, si shkak edhe i hapjes së kanalit në afërsi të argjinaturës së re të Darragjatit.

Gjatë inspektimit të fundit, konstatohej qartë se në bregun tjetër të lumit Buna, gërryerja, si shkak i rrjedhës së lumit Buna, kishte avancuar krahasuar me disa muaj më parë, e ndërsa më e keqja është se në këtë breg nuk janë kryer investime në mbrojtje të tokave bujqësore të zonës së Anamalit. Aktualisht, edhe niveli i ujit në Lumin Buna është i ulët, por rrjedha e saj po gërryen një pjesë të mirë të tokës bujqësore në këtë komunë.

Duke patur në vëmendje të veçantë problemin e banorëve të këtyre komunave si dhe rreziqet që u kanoseshin atyre në të ardhmen e afërt, Avokati i Popullit ndërmorri një proces hetimi dhe verifikimi të kuadrit ligjor që rregullonte pikërisht këtë çështje, ndoshta të padukshme për momentin, por me pasoja mjaft të mëdha për banorët, ekonominë e tyre familjare si dhe për ekosistemin e zonës.

Në zbatim të programit politik të qeverisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, ka si objektiv kryesor mes të tjerash edhe:

- Konsolidimin e pronësisë mbi tokën bujqësore dhe administrimin e qëndrueshëm të saj, si dhe
- Ruajtjen e tokës bujqësore nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë.....

Avokati i Popullit gjykoj se parashikimi i investimeve konkrete dhe afatgjata për shmangien e erozionit të mëtejshëm të tokës bujqësore në këto zona, është prioritar dhe jetik për banorët e këtyre komunave.

Nga ana tjetër, gjykoj se duhet të rriteshin edhe kapacitetet dhe burimet njerëzore, si dhe performanca e kryerjes së funksioneve të tyre në nivel të pushtetit qendror dhe vendor, siç është Drejtoria e Administrimit të Tokës në Qarkun e Shkodrës, me qëllim të verifikimit dhe ndërhyrjes në kohë ndaj këtyre çështjeve mjaft të mprehta të këtij komuniteti banorësh, të cilët e kanë të varur jetesën dhe nivelin e të ardhurave nga toka bujqësore, e cila është dhe mbetet e vetmja pasuri e tyre.

Në këtë kuadër, nga ana jonë iu rekomandua Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit marrja e masave urgjente lidhur me kryerjen e investimeve dhe shmangien e erozionit të tokës bujqësore në komunën e Bërdicës dhe Anamali në qarkun e Shkodrës.

Ky rekomandim iu është dërguar për dijeni edhe Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe drejtuesve të Komunave Anamali dhe Bërdicë, si njësitë e qeverisjes vendore më të prekura dhe rrezikuara nga një proces i tillë.

Së fundmi, ka patur një reagim zyrtar nga ana e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili na informon se për vitin 2012 janë parashikuar të investohen 500 milion lekë për mbrojtjen nga gërryerjet e lumit Buna në fshatin Oblikë. Ndërkohë është në fazën e përgatitjes së një projekti për mbrojtjen e tokës bujqësore nga gërryerjet në segmentin që përfshin Komunën Bërdicë, për të shikuar më pas edhe mundësitë e financimit të këtij projekti.

Pra, aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për mbrojtjen e tokës bujqësore në Komunat Anamali dhe Bërdicë. Projekti për Komunën

Anamali duhet të fillojë sa më parë për të mos u ndërprerë më pas gjatë periudhës së shirave të vjeshtës, ndërkohë që perspektiva e Komunës Bërdicë është ende e paqartë, përderisa MBUMK është ende në fazën e projektimit dhe më pas të shqyrtimit të mundësive për financim.

Subjektet tregtare

Krahas fermerëve, të cilët parashtruan shqetësimin e tyre lidhur me zvarritjet e miratimit të akteve të dëmshpërblimit, si dhe më pas pagimin real të këtyre dëmeve, pranë institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre edhe përfaqësues të subjekteve tregtare, të cilët ishin përjashtuar nga lista e përfituesve të dëmshpërblimit.

Konkretisht shtetasi Ymer Bardulla, me banim në qytetin e Shkodrës, shprehu shqetësimin e tij për mospërfitim të dëmshpërblimit për biznesin e tij, të përmbytur në qarkun e Shkodrës në fund të vitit 2010.

Ai shprehet se shoqëria e administruar prej tij ka pësuar një dëm të konsiderueshëm, i cili, mbi bazën e kërkesës së parashtruar nga ana e tij, është konstatuar edhe nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër përmes Akt-Kontrollit të hartuar me datë 24.09.2011, nga i cili ka rezultuar një dëm prej rreth 96 milion lek të vjetra.

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompesimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës”, në të cilin figuron edhe shoqëria Bardulla sh.p.k., e administruar nga ankuesi, por me një vlerë zero dëmshpërblimi, duke mos qenë në sinkron me dokumentacionin dhe gjendjen reale të konstatuar nga ekspertët e verifikimit të dëmeve të përmbytjeve, dhe duke shkaktuar kështu një bllokim të ushtrimit të aktivitetit të kësaj shoqërie si pasojë edhe të vështirësive financiare në shlyerjen e detyrimeve që ajo ka edhe ndaj institucioneve bankare, pranë të cilave kishte marrë kredi për të mundësuar ushtrimin dhe zgjerimin e sipërmarrjes së tij private.

Nga analiza e Vendimit të Këshillit të Ministrave, por edhe nga pohimet e ankuesit, rezultoi se nga rreth 260 biznese të verifikuara gjatë përmbytjeve të dhjetorit 2010, vetëm 3 prej tyre ishin parashikuar si përfitues të dëmshpërblimit, në bazë të VKM të sipërcituar, e në këtë këndvështrim, kishin lindur dyshime në komunitetin e biznesmenëve shkodranë për abuzime dhe njëanshmëri nga inspektorët verifikues të dëmeve.

Në këto kushte, ankuesi kërkoi ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për të verifikuar këto pretendime, duke synuar shqyrtimin e dokumentacionit të konstatimit të dëmeve në shoqërinë e tij dhe përfitimin e dëmshpërblimit, ashtu si edhe shoqëritë e tjera tregtare.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm dhe sqarimit përfundimtar të kësaj çështjeje, i jemi drejtuar fillimisht me anë të shkresës zyrtare me nr. K3/Y2-3 prot. datë 16.03.2012 Drejtorit të

Përgjithshëm të Tatimeve, për të kërkuar shpjegime lidhur me bazueshmërinë ose jo të pretendimeve të ngritura nga subjektet tregtare në qarkun e Shkodrës, nëse ishte shqyrtuar dokumentacioni i përcjellë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër për këtë shoqëri, cili ishte shkak i mospërfitimit të dëmshpërblimit në rastin konkret, duke patur parasysh edhe faktin se ankuesi dispononte edhe faturat tatimore të shitjeve që pasqyronin vlerën e mallit, cila ishte metodika dhe procedurat e ndjekura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë në shqyrtimin e dokumentacionit dhe klasifikimin e përfituesve të dëmshpërblimit, duke patur parasysh edhe faktin e numrit shumë të vogël të përfituesve dhe reagimin e ashpër që kjo listë ka shkaktuar në komunitetin e biznesmenëve të Shkodrës për shkak të përjashtimit të tyre nga lista pa baza dhe arsye të qarta ligjore, duke i cënuar ato në të drejtat dhe interesat e tyre të ligjshme mbi pasurinë e dëmtuar, si dhe gjithçka tjetër që kishte të bënte me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të pretendimeve të ngritura nga ankuesi.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, shkresën tonë ia ka kaluar thjesht për njohje, administrim dhe përgjigje Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, duke mos i dhënë përgjigje kërkesave për informacion të parashtruara nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Në këto kushte, me shkresën me nr. K3/Y2-5 prot. datë 11.04.2012 i jemi drejtuar me një kërkesë të përsëritur për shpjegime Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për të na sqaruar dhe informuar mbi kërkesat e parashtruara tashmë nga ana jonë.

Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk ka patur përsëri një informacion sqarues mbi kërkesat, informacionet dhe aktet mbi të cilat ka proceduar kjo Drejtori për klasifikimin e përfituesve dhe përfshirjen e tyre në listat e përfituesve të dëmshpërblimit.

Ndërkohë që Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, me shkresën me nr. 2848/1 prot. datë 11.04.2012, duke na sqaruar mbi subjektin tregtar që kishte parashtruar ankesën pranë institucionit të Avokatit të Popullit, por duke u shmangur nga pretendimet e tjera për përjashtim të subjekteve të tjera dhe njëanshmëri e subjektivizëm të inspektorëve tatimorë në përfshirjen e subjekteve përfituese në listat e dëmshpërblimit, thekson se subjekti ankues nuk përmbushte kriteret e përfitimit, pasi ai nuk kishte deklaruar pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër adresën në të cilën ai kishte depozituar mallin.

Theksojmë së malli dhe dëmi i tij ishin verifikuar tashmë nga inspektorët tatimorë, të përshkruar në Akt-Kontrollin e ushtruar me datë 24.09.2011, por që tashmë konsiderohej i pavlefshëm, dhe për të cilin Drejtori në shkresën e tij thekson se janë zbatuar Ligji nr. 7928 datë 27.04.1995 si dhe Udhëzimi nr. 17 datë 13.05.2008, por pa sqaruar me detaje lidhur me masat apo veprimet e ndërmarra nga kjo Drejtori për shkeljet e konstatuara nga ana e tyre.

Mbi bazën e këtyre qëndrimeve të mbajtura kryesisht nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër, sidomos po ti referohemi veprimtarisë dhe detyrave të ushtruara nga inspektorët tatimorë në vlerësimin e dëmeve të konstatuara, Avokati i Popullit gjykoi se subjekteve tregtare u ishte mohuar padrejtësisht e drejta e tyre për të përfituar dëmshpërblimin pas përmbytjeve që

ato kishin pësuar, te verifikuara tashmë nga inspektorët tatimor në rastin konkret, por edhe lehtësisht të verifikueshme nga publiku i gjerë përmes pamjeve filmike që shokuan mbarë komunitetin.

Mungesa e deklarimit të adresës nga subjekti, edhe nëse ishte e vërtetë, nuk përbën një arsye dhe shkak ligjor të qenësishëm, për më tepër po ti referohemi edhe fakti se inspektorët tatimor e kishin kontrolluar dhe vlerësuar në vend subjektin dhe gjendjen e mallit të tij, të pasqyruar në Akt-Kontrollin e përpiluar. Kjo mund të vlerësohet edhe si mangësi e paaftësi e inspektorëve, të cilët normalisht gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, duhet të kenë dijeni mbi vendin e depozitimit të mallit dhe ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve tregtare, për shkak të vjeljes së detyrimeve tatimore. Ndërkohë që kur bëhet fjalë për dëmshpërblimin e tyre, ato shprehen se subjekti nuk e ka të deklaruar këtë adresë, duke hedhur në këtë mënyrë hije dyshimi mbi njanshmërinë dhe subjektivizmin që ato kanë shfaqur për subjektet përfitues, sidomos po të kemi parasysh edhe vetë numrin e vogël të tyre dhe vetë aktivitetet që ato përfaqësojnë.

Avokati i Popullit gjykoi se çështja e parashtuar kërkonte angazhimin institucional të Ministrisë të Financave, duke vërejtur edhe zvarritjet e organeve tatimore që iu drejtuan, të cilët nuk sqaruan asnjëherë procedurat dhe kriteret që kishin zbatuar në këtë proces, por vetëm kalonin shkresat tek njëri-tjetri.

Në këtë kuadër iu rekomandua Ministrisë të Financave ngritja e një grupi të posaçëm pune për rishikimin e praktikave të vlerësimit të dëmeve të subjekteve tregtare në qarkun e Shkodrës, si dhe ndjekja e procedurave respektive për dëmshpërblimin e tyre, duke vlerësuar edhe vështirësitë financiare dhe mungesën e likuiditeteve që u kishin shkaktuar këto përmbytje.

Në përgjigje të rekomandimit tonë, Sekretari i Përgjithshëm i kësaj Ministrie ia ka kaluar për kompetencë rekomandimin tonë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila ndërkohë e kishte shprehur qëndrimin e saj aspak bashkëpunues me institucionin e Avokatit të Popullit, duke mos marrë në konsideratë pretendimet e subjekteve tregtare të përjashtuara nga lista e përfituesve të dëmshpërblimit.

Banorët e qytetit të Shkodrës

Ashtu siç u theksua më sipër, Këshilli i Ministrave miratoi vlerën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara në shumën 1 112 303 342 lekë si dhe listat e 7563 familjeve dhe subjekteve të biznesit të qarkut të Shkodrës, së bashku me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kulturat bujqësore dhe në biznese, sipas listave të njësive të qeverisjes vendore. Vendimi i qeverisë parashikon listën e familjeve të qarkut të Shkodrës, me shumën përkatëse të ndihmës për dëmet në kultura bujqësore, për bashkinë Shkodër dhe komunat përreth saj.

Nga një interpretim gramatikor, por duke analizuar edhe përmbajtjen e vendimit të Këshillit të Ministrave, Avokati i Popullit konstatoi se vendimi nuk parashikonte fare dëmshpërblimin e banorëve të qytetit të Shkodrës, të cilët vala e përmbytjeve i kishte goditur në brendësi të qytetit duke u shkaktuar dëme të mëdha në banesat dhe orenditë e tyre shtëpiake.

Në kuadër të verifikimit të kësaj situatë, me datë 05.04.2012 është organizuar pritja e një përfaqësie të këtij komuniteti banorësh në Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në qarkun e Shkodrës, për të marrë ankesat e banorëve dhe kryefamiljarëve të këtij qytetit, të cilët kishin shprehur më përpara pretendimet e tyre lidhur me mospërfitimin e shpërblimit për dëmet që u ishin shkaktuar në shtëpitë e tyre gjatë përmbytjeve të vitit 2010.

Banorët e përmbytur janë përfaqësuar në takim nga shtetasi Remzi Myrtja, i cili kishte kontaktuar direkt me Avokatin e Popullit gjatë vizitës që kishte patur në Shkodër si dhe në zonën ku ata banonin.

Konkretisht, bëhet fjalë për lagjen "Salo Halili", e cila ndodhet në hyrje të Shkodrës, në krahun e liqenit të tij. Banorët janë shprehur se kanë qenë për rreth 3 javë të izoluar nga uji, një situatë e pakonstatuar dhe imagjinuar më përpara në Shkodër, pavarësisht nga fakti se ky qytet është i rrethuar nga burime hidrike. Më tej, ato janë shprehur se pas kalimit të fazës së emergjencës, janë paraqitur komisionet e ngritura enkas për të kryer verifikimin dhe konstatimin e dëmeve në shtëpitë e tyre, ku niveli i ujit kishte arritur deri në 2m lartësi gjatë ditëve kritike, por që nga ai moment nuk kanë patur asnjë njoftim lidhur me procedurat që duhet të ndiqnin apo veprimet që kishin ndërmarrë autoritetet shtetërore.

Gjithashtu atyre nuk u ishte dorëzuar asnjë Akt-Konstatimi mbi llojin e dëmit dhe vlerën respektive të tij.

Duke qenë se banorët nuk kishin dijeni mbi përbërjen dhe përkatësinë e anëtarëve të komisionit, ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit në Shkodër verifikuan sa më sipër dhe rezultoi se anëtarë të komisioneve vlerësuese kanë qenë edhe nga Enti Kombëtar i Banesave Tiranë, të cilët kanë bërë edhe plotësimin e dokumentacionit dhe llogaritjen e vlerave të dëmeve të shkaktuara, sipas metodika dhe vlerave të përcaktuara të ndërtimit.

Ankuesit janë shprehur përfundimisht se kanë rregulluar dhe riparuar vetë dëmet që u janë shkaktuar, jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe familjare, janë tashmë në borxhe, për shkak të punimeve të kryera, disa janë edhe invalidë, si shtetasi Shkëlzen Pelinku, dhe se tashmë kërkojnë përmbyshjen e premtimeve të qeverisë për dëmshpërblimin e tyre nga përmbytja.

Në këtë kuadër, për shqyrtimin e këtyre ankesave dhe pretendimeve të këtyre banorëve, të cilat sipas përfaqësuesit të tyre, Remzi Myrtja, janë rreth 200 familje të asaj lagje, i jemi drejtuar me shkresën me nr. K3/R29-2 prot. date 10.04.2012 Entit Kombëtar të Banesave Tiranë, duke vënë në dijeni edhe Kryetarin e Bashkisë dhe Prefekten e Qarkut Shkodër, për të kërkuar shpjegime lidhur me faktin nëse ishte shqyrtuar dokumentacioni i mbledhur dhe përpiluar nga ekspertët e EKB Tiranë, cili ishte shkaku i mospërfitimit të dëmshpërblimit në rastin konkret, cilat ishin procedurat ligjore të ndjekura nga autoritetet vendore dhe qendrore lidhur me hartimin dhe përcjelljen e dokumentacionit me synimin e miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave që do të parashikonte masën dhe procedurat konkrete të dëmshpërblimit të familjeve të prekura nga përmbytjet.

Gjatë periudhës së verifikimit të këtyre pretendimeve, ankuesit janë vënë vazhdimisht në dijeni, me shkresa zyrtare në adresat e tyre respektive, mbi procedimin e iniciuar nga Avokati i Popullit.

Në përgjigje të shkresës tonë ka reaguar fillimisht Prefektura e qarkut Shkodër, e cila me shkresën me nr. 755/1 prot. date 27.04.2012 na ka vënë në dijeni të faktit Këshilli i qarkut Shkodër ka përcjellë brenda pesë ditëve të gjithë praktikën e verifikimit dhe vlerësimit të dëmeve në Ministrinë e Brendshme, e cila brenda pesë ditëve duhet t'ia paraqiste Këshillit të Ministrave për miratim, projekt-vendimin përkatës së bashku me vlerën e dëmit të shkaktuar nga përmbytja, së bashku me listën emërore të kryefamiljarëve të dëmtuar/bizneseve, të detajuar për dëmet në objekte banimi, bujqësi e blegtori, ndërtesa me karakter bujqësor, objekte të prodhimit dhe përpunimit agro-bujqësor, makineri dhe pajisje, rezervatet e rritjes së peshkut, bimë dekorative, si dhe objekte ndihmëse, sipas formularëve tip.

Siç është konstatuar dhe theksuar edhe më sipër, Këshilli i Ministrave ka miratuar një vendim vetëm përsa i përket dëmshpërblimit të fermerëve apo familjarëve të qytetit të Shkodrës për dëmet në kulturat bujqësore dhe blegtori, si dhe subjektet tregtare, por që gjithsesi ka ngelur një vendim ende i pazbatuar.

Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngrituara nga familjarët e qytetit të Shkodrës lidhur me zvarritjet në akordimin e dëmshpërblimit të premtuar pas përmbytjeve në qytetin e Shkodrës, së fundmi Enti Kombëtar i Banesave na ka vënë në dijeni të faktit se ka plotësuar brenda afateve ligjore detyrimet e tij lidhur me kryerjen e procedurave të matjes dhe vlerësimit të dëmeve.

Duhet theksuar fakti se procedura e konstatimit dhe vlerësimit të dëmeve është parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 10 datë 06.01.2011 "Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut e përmbytjet në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Durrës".

Gjatë verifikimit pranë Entit Kombëtar të Banesave, si dhe duke u bazuar në shkresën zyrtare që Drejtori i EKB i ka drejtuar Avokatit të Popullit, rezulton se dokumentacioni përkatës i është drejtuar brenda afateve ligjore organeve të pushtetit lokal, ashtu siç theksohet edhe nga Prefekti i qarkut Shkodër, dhe më pas Ministrisë së Brendshme për të përgatitur aktet ligjore, të cilat nuk janë zbardhur ende nga Këshilli i Ministrave, për shkak të shifrës së madhe të dëmshpërblimit që duhet tu akordojë Qeveria banorëve për dëmet e pësuar në banesat dhe pajisjet e tyre shtëpiake.

Konkretisht bëhet fjalë për një shumë totale prej 2 097 440 930, e cila është shumë më e madhe se shuma prej 1 112 303 342 që Këshilli i Ministrave ka miratuar me vendimin nr. 842 datë 06.12.2011 "Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës", por që ka ngelur ende e pa ekzekutuar për shkak të mungesës së fondeve, konfirmuar edhe në përgjigjen e Administratorit të KESH sh.a. dhe të Ministrisë së Financave.

KONKLUZIONE

Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje situatën e krijuar pas përmbytjeve në qarkun e Shkodrës. Në këtë aspekt, vlerësojmë angazhimin serioz të strukturave shtetërore me qëllim shmangien e dëmeve në njerëz si dhe zbutjen e pasojave që po i kanoseshin pasurive të tyre.

Gjithsesi Avokati i Popullit, duke patur parasysh edhe mundimin dhe dëmet e mëdha që ka pësuar komuniteti i qarkut Shkodër, gjykon se duhen marrë tashmë masa konkrete për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmbytjet, në qarkun e Shkodrës” për dhënien e dëmshpërblimit të fermerëve dhe subjekteve tregtare. Konkretisht rekomandojmë:

- Alokimin e fondeve nga KESH në një Depozitë të veçantë të Qeverisë Shqiptare. Mungesa e fondeve nga KESH nuk mund dhe duhet të jetë arsye apo shkak ligjor për zvarritjen e dhënies së dëmshpërblimit të parashikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave.
- Duhet marrë në konsideratë pretendimet e subjekteve tregtare tyre si dhe procedurat e vlerësimit të dëmeve dhe klasifikimit të tyre jashtë listës së përfituesve. Në këtë aspekt, shprehim kritikën tona institucionale për mungesën e bashkëpunimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, e cila për asnjë moment nuk vuri në dispozicion të Avokatit të Popullit informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar në rrugë zyrtare.
- Duhet miratuar një vendim i ri i Këshillit të Ministrave ku të parashikohen ato subjekte të lëna në harresë gjatë procedurave të përpilimit të dokumentacionit nga ana e DRBUMK Shkodër, me qëllim që të gjithë fermerët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të përfitojnë dëmshpërblimin ashtu si dhe bashkëfshatarët e tyre.
- Të miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave për dëmshpërblimin e banorëve të qytetit të Shkodrës, të cilat kanë pësuar dëme serioze në banesat dhe orenditë e tyre shtëpiake.
- Duhet miratuar një Udhëzim i përbashkët mes Ministrit të Financave dhe Ministrit të Brendshëm, në zbatim të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82 datë 06.12.2011, për kryerjen e pagesave për personat përfitues.
- Duhet realizuar investime konkrete brenda një afati të shkurtër, duke shmangur periudhën e vjeshtës dhe shirave të mundshëm, me qëllim që të shmangen përmbytjet e tjera të zonave të rrezikuara.

Avokati i Popullit përmes këtij Raporti të Veçantë kërkon që të njohë Kuvendin e Shqipërisë me situatën e krijuar dhe masat që duhen marrë nga autoritetet shtetërore respektive për të zbutur pasojat e përmbytjes dhe përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga Vendimi i Këshillit të Ministrave.